



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

**PROGRAM LËNDOR PËR ARSIMIN BAZË
NË INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE PËR TË MITUR**

Lënda: Art pamor

Klasat: I, II, III, IV, V

Tiranë, 2018



	Emër Mbiemër	Pozicioni	Data	Nënshkrimi
Koordinoi:	M.Hala	Specialist i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulave dhe Standardeve	__ .11.2018	
Pranoi:	D.Rapti	Drejtori i Drejtorisë së Kurrikulës, Standardeve dhe Kualifikimit	__ .11.2018	

Përmbajtja e Programit.

I. Hyrje	5
II. Korniza konceptuale e programit.....	6
1. Qëllimet e programit të artit pamor	9
2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e fushës	9
3. Lidhja e artit pamor me temat ndërkurrikulare	12
4. Lidhja e artit pamor me fushat e tjera kurrikulare	13
5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj	16
6. Ndarja e peshave për tematikë për secilën klasë.....	20
III. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë.....	21
1. SHKALLA E PARË DHE E DYTË.....	Error! Bookmark not defined.
1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi artistik	22
1.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike	28
1.3 Tematika: Historia, arti dhe shoqëria.....	37
IV. Udhëzime metodologjike	43
V. Udhëzime për vlerësimin	46
VI. Materiale dhe burime mësimore.....	47

Tabelat dhe digramat

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit.....	8
Digrama 2: Rezultatet e të nxënit të komptencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor për shkallën e parë.	11
Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.	14
Digrama 4 : Kompetencat e lëndës dhe tematikat e lëndës.	17
Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës	17
Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë.....	20

Fusha e arteve¹ është pjesë e rëndësishme e kurrikulës, në të cilën përfshihen aspekte të kulturës materiale, shpirtërore, artistike, intelektuale dhe emocionale, ku ndërveprojnë kultura dhe shoqëria. Mësimi i arteve u ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar njohuritë artistike përmes mjeteve shprehëse si: tingujve, ngjyrave, formave, fjalës, lëvizjeve. Ato mësohen, formohen dhe kultivohen përmes teknikave e proceseve artistike, nxisin të mësuarit konkret të artit, gjatë procesit mësimor në shkollë dhe në jetën e përditshme. Kompetencat përmbajtësore, që zhvillon fusha e arteve në të gjitha shkallët, kontribuojnë në arritjen e kompetencave kyç në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Fusha e arteve zhvillohet përmes lëndëve: *art pamor, muzikë, kërcim dhe dramë* si lëndë të detyrueshme në **shkallën 1, shkallën 2 dhe shkallën 3**. Fusha e arteve **në shkallën e parë** fokusohet në ndërgjegjësimin e nxënësve për njohjen e dukurive, fenomeneve, objekteve dhe situatave artistike në mjedisin që i rrethon. **Në shkallën e dytë**, fusha e arteve fokusohet në aftësimin e nxënësve në vëzhgimin, reflektimin, komunikimin dhe përdorimin e informacionit nga burime të ndryshme. Artet janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe mundësitë e nxënësve për të njohur gjuhën artistike të arteve, për të realizuar, për të prezantuar punë të ndryshme artistike, për të vlerësuar veprat e arteve të ndryshme. Artet stimulojnë ndërgjegjësimin trupor, ushqejnë imagjinatën dhe kontribuojnë në zhvillimin e vetëbesimit, ndihmojnë në krijimin dhe zhvillimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar nëpërmjet elementeve dhe vlerave artistike kulturore të trashëgimisë sonë kombëtare si dhe në pasurimin e botëkuptimit të nxënësve.

¹Hyrja dhe pjesët e sqaruese të programit, janë njësoj si për shkallën e parë ashtu edhe për shkallën e dytë.

I. Hyrje

“Arti pamor” është një mënyrë për të krijuar dhe komunikuar nëpërmjet imazhit. Lënda e “Artit pamor” është një lëndë e veçantë dhe ka kërkesat e veta specifike të të mësuarit. Arti është një mënyrë e natyrshme dhe e kënaqëshme e pasurimit të botës së fëmijëve. Veprimtaritë e “Artit pamor” bëjnë të mundur që nxënësit të bëjnë lidhjen midis botës reale dhe imagjinare, të organizojnë dhe të shprehin vizualisht idetë, ndjenjat dhe eksperiencat nëpërmjet vizatimit, pikturës, konstruksioneve etj. Edukimi nëpërmjet “Artit pamor” siguron zhvillimin e krijimtarisë dhe përvojave personale nëpërmjet zbulimit, kërkimit, eksperimentimit, trillimit, vizatimit dhe përdorimit të një sërë mjeteve dhe teknikave. Kjo lëndë promovon vëzhgimin dhe ndihmon nxënësit të fitojnë ndjeshmëri për botën vizuale, hapësinore dhe të prekshme dhe për eksperiencat estetike. Zhvillimi i aftësive perceptuale i ndihmon nxënësit të shijojnë dhe interpretojnë mjedisin vizual dhe veprat e artit njëkohësisht lehtëson të nxënët në të gjithë kurrikulën e arsimit fillor. Krijimtaria në art kontribuon në formimin e një identiteti personal e të vetëbesimit dhe ndihmon në krijimin e vetëdijes kulturore dhe ndjeshmërisë.

Ky program në arsimin bazë ka për qëllim: të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë krijuese, komunikuese, të kuptojnë botën, që i rrethon , nëpërmjet “Artit pamor”.

Që në fëmijërinë e hershme, në mënyrë shumë të natyrshme, fëmijët bëjnë shenja, zhgaravina dhe vizatojnë me çdo lloj materiali. Nëpërmjet zhgaravinave një fëmijë “bën një shenjë në këtë botë” është një nga shembujt e hershëm të shtysës personale. Fëmijët fillojnë të tregojnë që e pëlqejnë ambjentin e tyre dhe njohin objektet që u duhen. Me kalimin e viteve këto imazhe shenjash zhvillohen sipas stadeve specifike. Ky progres i zhvillimit grafik fillon nga mosha 2 vjeç dhe vazhdon deri në adoleshencë. Edhe pse në fillimet e veta , ai është natyral dhe spontan, më vonë ai kërkon një mësimdhënie të përshtatshme.

Lënda e artit pamor në arsimin fillor i ndihmon fëmijët të zhvillojnë potencialin e tyre krijues në lidhje me botën vizuale dhe aftësitë për të simbolizuar, shprehur dhe komunikuar përmes imazheve.

Të mësuarit në artin pamor u siguron nxënësve një sërë eksperiencash emocionale, njohëse, psikomotore, sociale dhe estetike.

Nxënësit kanë mundësi të krijojnë imazhet e tyre, duke u përfshirë në procesin krijues për të zbuluar mundësi të shumta të kombinimit të materialeve me gjuhën vizuale. Në këtë nivel ata mësojnë të ushtrojnë mendimin kritik dhe të zhvillojnë ndjesitë e tyre estetike nëpërmjet vlerësimit jo vetëm të punëve të tyre dhe të shokëve/shoqeve, por edhe të veprave të artit, të objekteve tradicionale dhe imazheve të mediave të marra nga historia dhe trashëgimia kulturore e të tashmes dhe të shkuarës. Nëpërmjet lëndës së artit pamor, në ciklin e ulët, nxënësit inkurajohen të bëjnë lidhjen e artit pamor me lëndët e tjera në kurrikul. Në këtë mënyrë ata hapin një dritare me botën për të zbuluar karakteristikat e veçanta të saj dhe të kuptojnë më mirë kulturën e tyre. Në këtë mënyrë nxënësit zhvillojnë identitetin e tyre kulturor dhe përgatiten për rolin e tyre si qytetar.

II. Korniza konceptuale e programit

Hartimi i programit lëndor rrjedh nga korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, kurrikula bërthamë dhe plani mësimor i arsimit bazë. Si i tillë ky dokument i shërben:

- **nxënësit**, për zhvillimin e kompetencave kyçe të të nxënit gjatë gjithë jetës dhe të kompetecave të lëndës së artit pamor, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohet në shoqëri;
- **mësuesit**, për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin veprimtarisë mësimore dhe arritjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- **prindit**, për njohjen e rezultateve e pritshme të fëmijëve dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara;
- **hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Programi përmban edhe **tri tematikat** të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat në funksion të kompetencave të lëndës dhe kompetencave kyçe. Në program paraqiten edhe **koha mësimore për secilën tematikë**, që ndryshon nga klasa në klasë.

Kompetencat kyçe të të nxënit në lëndën e artit pamor janë:


- Krijimi artistik.
- Realizimi i punimit.
- Vlerësimi i veprave të artit.

Vendi, që zë zhvillimi i çdo kompetence në program, varet në mënyrë të veçantë nga natyra e tematikës. Kompetenca e parë dhe e dytë kanë përparësi për njohuritë që duhen fituar. Ato nënkuptojnë një proces në të cilin merren njohuri specifike të artit pamor mbi gjuhën artistike, rregullat, parimet dhe mjetet specifike, ku gjithashtu zhvillohen aftësitë komplekse psikomotore brenda një kohe të mjaftueshme për t'u asimiluar. Kompetenca e tretështë thelbësore për zhvillimin e mendimit kritik dhe ndjenjës estetike të nxënësit. Kjo kompetencë ndjek dy kompetencat e para duke vendosur në qendër proceset e komunikimit dhe vlerësimit. Vendi, që zë kjo kompetencë, vjen duke u rritur gradualisht nga një cikël në tjetrin, ashtu siç njohuritë, që lidhen me dy kompetencat e tjera, konsolidohen në bashkëpunim me zhvillimin intelektual dhe shpirtëror të nxënësve.

Përdorimi i **metodologjive efikase në mësimdhënien e artit pamor** është kusht parësor për zbatimin e programit për arritjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes. Në këtë program **vlerësimi i nxënësve** është komponent thelbësor për përmirësimin e arritjeve të nxënësve dhe procesit të të nxënit.

Programi i artit, nga pikëpamja e organizimit të përmbajtjes, paraqitet në diagramine mëposhtëm:

Digrama 1: Korniza konceptuale e programit



1. Qëllimet e programit të artit pamor

Programi i artit pamor, nëpërmjet përmbajtjes të përcaktuar sipas tematikave, ka si qëllim zhvillimin e njohurive dhe koncepteve bazë për formimin artistik, zbulimin e cilësive vizuale të objekteve dhe imazheve nga mjedisi, zhvillimin e aftësive pamore, të menduarit kritik dhe krijues, zhvillimin personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve. Ky program synon aftësimin e nxënësve për të njohur dhe vlerësuar vepra të artit shqiptar dhe atij botëror nga periudha dhe kontekste të ndryshme kulturore dhe historike. Gjithashtu synon përfshirjen në veprimtari artistike, duke manifestuar vlerësim ndaj artit pamor kombëtar si pjesë e pandashme e vlerave të artit shqiptar, pjesëmarrjen në jetën kulturore të klasës, shkollës, komunitetit, duke i vënë në shërbim të mjedisit ku jeton aftësitë dhe talentin e vet, ndërveprimin në mënyrë sociale, kulturore dhe intelektuale me grupet të ndryshme kulturore apo etnike, zhvillimin e kompetencave të artit pamor për të krijuar dhe realizuar punë të ndryshme artistike.

Në këtë lëndë nxënësi kupton dhe argumenton qëndrimet e veta, duke ua paraqitur të tjerëve, edukohet të punojë në grup, ndihet i suksesshëm në artin pamor.

2. Lidhja e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit tënxënies. ***Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies.*** Organizimi i mësimit të artit pamor me bazë kompetencat përqëndrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

P.sh. kompetenca e artit pamor “Krijimi Artistik” përfshin njohuritë mbi gjuhën vizuale të cilat i zbulojnë në objektet, ambjentin që i rrethon, veprat e artit dhe i përdorin ato në krijimet e tyre për të shprehur ndjenja e mendime të realizuara përmes teknikave artistike duke zgjidhur problemet në detyrën e tyre në mënyrë të pavarur.

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të lëndës së artit pamor, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe në këndvështrimin e përshtatshmërisë në jetë, shoqëri dhe punë.

Në zhvillimin e kompetencave, nxënësi gjithashtu, zhvillon kompetencat kyçe në lidhje me krijimtarinë, realizimin, vlerësimin e e artit pamor, përpunimin e informacionit për veprat e artit, prezantimin e detyrave të zhvilluara, punën në grup, komunikimin efektiv etj.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyçe me kompetencat e lëndës së artit pamor mësuesi ndjek këto hapa:

- përzgjedh rezultatit/et e të nxënit për kompetencat kyçe që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetenca kyç për secilin vit mësimor rezultatit/et e të nxënit për shkallë, për kompetencat kyçe;
- përzgjedh rezultatit/et e të nxënit për shkallë për kompetencat e lëndës së artit pamor që synon të arrijë nxënësi;
- zbërthen në rezultate të nxëni për kompetencat e lëndës së artit pamor për vit mësimor, rezultatit/et e të nxënit për shkallë;
- përzgjedh përmbajtjen/et mësimore, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizon rezultatet e të nxënit të kompetencave të artit pamor në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- planifikon mësimdhënien duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t’i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndën e artit pamor.

Digrama 2: Rezultatet kryesore të të nxënit sipas kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së artit pamor.

<i>Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Merr pjesë aktive në veprimtaritë artistike. • Kupton mesazhet që u drejtohen. • Shprehet në mënyrë të përshtatshme me anë të gjuhëve, simboleve, shenjave, kodeve dhe formave artistike. • Komunikon efektivisht dhe shfrytëzojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese mundësitë e të shprehurit.
<i>Kompetenca e të menduarit</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Mendon në mënyrë krijuese. • Merr dhe përpunon njohuritë në mënyrë të pavarur, krijuese dhe me përgjegjësi. • Zhvillon aftësitë për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe ndërvepruese. • Ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari.
<i>Kompetenca e të mësuarit për të nxënë</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh mjetet për të realizuar një krijim. • Përdor burime të ndryshme për të realizuar një krijim. • Zgjidh në mënyrë të pavarur detyrën e dhënë.
<i>Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Ndërrmer nisma për të zhvilluar aktivitete të artit pamor brenda dhe jashtë klasës, duke kontribuar në mënyrë krijuese.
<i>Kompetenca personale</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillon besimin tek vetja gjatë krijimit artistik. • Respekton punën e vet dhe të të tjerëve. • Bashkëpunon me të tjerët pamvarësisht kulturës, aftësive dhe nevojave brenda dhe jashtë shkollës për një qëllim të përbashkët.
<i>Kompetenca qytetare</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Diskuton dhe bashkëpunon me të tjerët për çështje të ndryshme kulturore. • Zbaton rregullat e mbajtjes në rregull të vendit të punës.
<i>Kompetenca digjitale</i>
<ul style="list-style-type: none"> • Njeh dhe përdor mjetet kompjuter, aparat fotografik dixhital, video CD, DVD etj.

3. Lidhja e lëndës së artit pamor me temat ndërkurrikulare

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Arti pamor ka një shumëllojshmëri të veprimtarive në jetën e përditshme dhe është i lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e shumëfishtë sepse ai, jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këto komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështunë shqyrtimin e temave ndërkurrikulare: *Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; të drejtat e njeriut; vendimmarrja morale; zhvillimi i qëndrueshëm; mjedisi; ndërvarësia; bashkëjetesa paqësore*; nxënësi kontribuon përmes aktiviteteve artistike, duke shpalosur vlerat e kulturës së vet, duke respektuar dhe promovuar vlerat e kulturave të tjera, duke bashkëpunuar vetëm dhe në grup në aktivitete të ndryshme, duke dhënë kontributin e vet, duke u dhënë zgjidhje situatave dhe problemeve të ndryshme pamore/artistike, duke përdorur gjuhë të saktë artistike për të komunikuar vlera dhe qëndrime, duke shpjeguar teknika dhe procese të ndryshme, që lidhen dhe me fusha të tjera ,që ata mësojnë. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave të artit pamor me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi përdor aftësitë e tij pamore, që kanë të bëjnë me simbole, vizatime grafike, për të zhvilluar një marrëdhënie aktive në mjedisin e tij. Ai mund të shpjegojë fenomenet dhe dukuritë pamore në botën e tij dhe ndërvarësitë e mjedisit dhe botës njerëzore (format dhe ngjyrat).

Nxënësi mëson të komunikojë dhe shprehet përmes gjuhës pamore në krijimet e tij nëpërmjet përdorimit të ideve origjinale, gjuhës artistike, teknikave të larmishme, duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike.


Nxënësi fillon të familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave të artit, duke shpjeguar kuptimin e tyre dhe duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

4. Lidhja e lëndës së artit pamor me fushat e tjera kurrikulare

Arti pamor është i lidhur me lëndët brenda fushës së saj, por edhe me fusha të tjera të nxëni në kurrikul. Elementet e artit pamor, ritmi, harmonia, dinamika, etj., lidhen shumë mirë me disiplinat e tjera artistike si: kërcimin, muzikën, teatrin, por edhe me matematikën, gjuhën, shkencat shoqërore. Nxënësit nxiten të bëhen të vetëdijshëm për një numër procesesh , që lidhen me karakteristikat kryesore të kompetencave kroskurrikulare, të cilat krijojnë lidhje me njohuritë në lëndët e tjera. Kompetencat e artit pamor mundësojnë nxënësit të përdorin informacionin, të zgjidhin problemin, të ushtrojnë mendimin kritik, të zbulojnë metoda pune efektive, të përdorin informacionin dhe komunikimin teknologjik, të zhvillojnë identitetin e tyre personal, të punojnë me të tjerët dhe të komunikojnë në mënyrë të përshtatshme. Kështu që në arsimin fillor, mësuesit përmes mësimit të shumë përmbajtjeve mësimore, duhet t'u japin mundësinë fëmijëve të konsolidojnë përvojat që ata kanë krijuar dhe që i sjellin në klasë, duke i pasuruar dhe duke u dhënë drejtim të mëtejshëm këtyre përvojave.

Më poshtë paraqiten disa lidhje ndërlëndore të artit pamor me lëndë të tjera.

Digrama 3: Lidhja ndërmjet artit pamor dhe fushave të tjera.



5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj

Bazuar në këtë kurrikul, lënda e artit pamor synon të përmbushë *3 kompetencat e lëndës*, të cilat lidhen me kompetencat kyç që një nxënës duhet të zotërojë gjatë jetës së tij dhe që arrihen nëpërmjet *3 tematikave kryesore*.

Kompetencat e lëndës:

Kompetenca 1: Krijimi artistik.

Kompetenca 2: Realizimi i punimit

Kompetenca 3: Vlerësimi i veprave të artit

Tematikës e lëndës:

Tematika 1: Gjuha dhe komunikimi artistik.

Tematika 2: Teknikat dhe proceset artistike.

Tematika 3: Historia, arti dhe shoqëria.

Digrama 4 : Kompetencat që formohen përmes tematikave




Tabela 1: Kompetencat e lëndës, përshkrimi dhe realizimi i tyre nëpërmjet tematikave të lëndës

Kompetencat e lëndës së artit pamor	Përshkrimi i kompetencave	Realizimi nëpërmjet tematikave
Krijimi artistik	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - mëson të përdorë imagjinatën në çdo hap të procesit krijues; - eksperimenton në mënyra të ndryshme; - transformon materiale gjithnjë e më të vështira; - përdor në mënyra të larmishme gjuhën vizuale duke pasuruar idetë e tij krijuese; - inkurajohet të përshkruajë eksperiencat krijuese dhe të identifikojë se çfarë ka mësuar nga ajo. 	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon punë dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike; - përdor një sërë stimuljsh në përshtatje me moshën për krijimet e tij; gjuha vizuale si: vija, forma, ngjyra, etj., dhe i organizimi i tyre në hapësira dy dhe tre dimensionale për të komunikuar ide është pjesë e rëndësishme e procesit krijues; - krijon duke u mbështetur te eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por ndonjëherë edhe në grup; - reflekton mbi përvojat krijuese dhe ta ndajë me të tjerët këtë përvojë.
Realizimi i punimit	<p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton në mënyra të ndryshme gjatë krijimit të vet; - transformon materiale gjithnjë e më të vështira; përdor teknika artistike të larmishme për të krijuar punë dy dhe tre dimensionale; - përdor gjuhën vizuale duke pasuruar idetë e tij krijuese dhe duke i ndarë me të tjerët; - përshkruan eksperiencat krijuese dhe të identifikojë se çfarë ka mësuar nga ajo; 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon punë dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike dhe një sërë stimuljsh në përshtatje me moshën; - ndjek procesin e realizimit si pjesë e rëndësishme e krijimtarisë, përmes eksperiencave, vëzhgimit dhe imagjinatave e nxënësit janë pjesë e rëndësishme e procesit krijues; - krijon nga kujtesa, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale por ndonjëherë edhe në grup; - inkurajon mbi përvojat e tij krijuese dhe për të folur mbi

Vlerësimi i veprave të artit		aspekte që janë të rëndësishme për të;
	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbulon një sërë veprash arti dhe kupton që këto vepra u përkasin periudhave historike dhe kulturave të ndryshme ku ato janë krijuar; - pasuron vëzhgimin e tij dhe bën të mundur të rrisë vlerësimin ndaj diversitetit kulturor; - përshkruan eksperiencën e tij vlerësuese ; - identifikon çfarë mësoi prej saj. 	<p>Nxënësi:</p> <p>merr pjesë në aktivitete të shkurtra, në të cilat ai vëzhgon vepra arti nga e shkuara, e tashmja dhe nga kultura të ndryshme, duke përfshirë edhe krijimet e tij dhe të nëpërmjet posterave apo në rrugë elektronike audio vizuale, të përshtatshme për eksperiencën kulturore të kësaj grupmoshe;</p> <ul style="list-style-type: none"> - komunikon vlerësimin me gojë ose me shkrim.

6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Lënda e artit pamor zhvillohet për 35 javë mësimore me nga 1 orë secila, pra gjithsej 35 orë për secilën klasë. Në klasën përgatitore, kohëzgjatja e “orës së mësimi” llogaritet me 25-30 minuta. Programi i lëndës së artit pamor specifikon peshën (orët e sugjeruara) e secilës tematikë për secilën shkallë dhe klasë. Shuma e orëve sugjeruese për secilën tematikë është e barabartë me sasinë e orëve vjetore, të përcaktuar në planin mësimor të arsimit bazë. Kjo ka si qëllim që përdoruesit e programit të orientohen për peshën që zë secila tematikë në orët totale vjetore. Edhe në këtë rast, klasa përgatitore ruan specifikat e saj në përcaktimin e sasisë së orëve vjetore për secilën kompetencë të lëndës.

Tabela 2: Orë të sugjeruara për çdo tematikë

	Gjuha dhe komunikimi artistik	Teknikat dhe proceset	Historia, arti dhe shoqëria	Gjithsej orë
Klasa parë	5	22	3	30 orë
Klasa e dytë	5	22	3	30 orë
Klasa e tretë	5	22	3	30 orë
Klasa e katërt	5	22	3	30 orë
Klasa e pestë	5	22	3	30 orë
Shkalla e parë	25	110	15	150 orë

7. Përmbajtja e shkallës së parë dhe të dytë

Në programin e artit pamor për shkallën e parë dhe të dytë janë paraqitur përmbajtjet e tematikave:

Gjuha dhe komunikimi artistik.

Teknikat dhe proceset artistike.

Historia, kultura dhe shoqëria.

Këto tematika, janë bazë për të ndërtuar njohuri e shkathtësi dhe qëndrime e vlera. Tematikat janë bazë për të siguruar rezultatet e të nxënit, sipaskompetencave të artit pamor, për çdo shkallë të paraqitura në tabelë në fillim të çdo tematike.

Përsecilën tematikë, sipas klasave të shkallës , janë paraqitur njohuritë për secilën klasë të shkallës së parë (*klasa përgatitore, klasa e parë dhe klasa e dytë*) dhe shkallës së dytë (*klasa e tretë, klasa e katërt, klasa e pestë*). Aftësitë, qëndrimet dhe vlerat, që duhet të demonstrojë nxënësi lidhur me tematikat përkatëse, paraqiten vetëm në nivel shkalle për secilën shkallë. Për secilën **tematikë** është përcaktuar grupi i njohurive.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë sipas tematikave dhe në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e koncepteve dhe shprehive të artit pamor në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (mësuesit dhe autorët e teksteve).

Për “përkthimin” e programit të shkallës në tekste mësimore apo programe lëndore për çdo vit mësimor, aftësitë dhe orë e tematikave do të jenë të shpërndara në kapituj/njësime mësimore të renditura logjikisht njëri pas tjetrit.

Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

Në program, për secilën klasë, afërsisht 40 % e orëve mësimore totale janë menduar për ndërtimin e njohurive të reja lëndore dhe 60 - e tyre janë menduar për krijimin e situatave të të nxënit (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

8 . REZULTATET E TË NXËNIT TË KOMPETENCAVE, SIPAS TEMATIKAVE, SIPAS SHKALLËVE

1.1 Tematika : Gjuha dhe komunikimi artistik

Përshkrimi i Tematikës:

Nxënësi krijon punë dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike. Ai përdor një sërë stimulësh në përshtatje me moshën për krijimet e tij. Gjuha vizuale si: vija, forma, ngjyra, etj. dhe organizimi i tyre në hapësira dy dhe tre dimensionale për të komunikuar ide është pjesë e rëndësishme e procesit krijues. Nxënësi krijon duke u mbështetur tek eksperiencia, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale, por ndonjëherë edhe në grup. Nxënësi inkurajohet të reflektojë mbi përvojat krijuese dhe ta ndajë me të tjerët këtë përvojë.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor ide personale dhe stimuj për krijim; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; identifikon këto elemente të artit pamor në mjedisin që e rrethon apo në vepra arti; përfundon krijimin e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese.
- **Realizimi i punimit:** përdor ide krijuese i frymëzuar nga stimuj dhe teknika artistike; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; organizon elementet e artit në hapësira dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknikën e duhur për të përcjellë një mesazh; përfundon punën e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese.
- **Vlerësimi artistik:** zbulon vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, imazhe të medias, krijimet e veta dhe të të tjerëve, për elementet e përmbajtjes; zbulon një vepër arti, objekte të trashëgimisë, në kontekstin e tyre social kulturor;

komunikon emocionet e tij/saj dhe atë që zbuloi mbi veprën e artit; bën një gjykim kritik ose estetik; ndan eksperiencën e tij të vlerësimit.

KLASA 1

Vija:

- E hollë, e trashë
- Horizontale, vertikale

Forma dy dimensionale:

- Forma natyrale.
- Forma gjeometrike.

Ngjyrat:

- Ngjyrat primare: *e verdhë, e kuqe (magenta), blu (cian).*
- Ngjyrat sekondare: *jeshile, portokalli, lejla.*

Vlera:

- Drita dhe hija.

Tekstura :

- Materiale me tekstura të ndryshme.

Motivi:

- Motive të ndryshme në krijim.

Forma tre dimensionale:

- Format tre dimensionale.

Organizimi i hapësirës (parimet):

- Dallon që vija ka cilësi të ndryshme dhe krijon siluetën e objektit.
- Krijon figura dhe objekte të njohura nëpërmjet linjës.
- Përdor vijën horizontale për të krijuar vijën e horizontit.
- Vizaton forma të objekteve të thjeshta natyrale dhe gjeometrike në krijim, të cilat i vëzhgon në mjedisin që e rrethon.
- Përdor forma të ndryshme në krijim.
- Eksperimenton dhe zbulon ngjyat primare (parësore) dhe sekondare (dytësore) në krijim dhe natyrë.
- Përzien ngjyrat e para për të përfutur të dytat në krijim.
- Dallon dhe vizaton dritën dhe hijen mbi një objekt të thjeshtë.
- Kupton teksturën nëpërmjet të prekurit dhe të parit;
- Dallon dhe krijon teksturën me materiale të ndryshme.
- Zbulon motive dhe i përdor në krijim duke i përsëritur me një ritëm të caktuar. (retë në qiell, vijëzime, pikat e shiut mbi ujë, murin me tulla, etj).
- Kupton formën tre dimensionale duke krijuar forma të thjeshta me plastelinë dhe konstruksione, (volumi te kafshët, te lodrat, te topi, kutia, etj).
- Kupton se si njerëzit dhe objektet zënë vend në hapësirë.
- Dallon struktura të thjeshta në mjedisin që e rrethon dhe i përdor në krijim.
- Identifikon objektet simetrikë në natyrë dhe mjedisin që e rrethon dhe i vizaton.

<ul style="list-style-type: none"> - Renditja, krahasimi. - Simetria 	
KLASA 2	
<p>Vija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - E hollë, e trashë. - Horizontale, vertikale. - E shkurtër e gjatë. <p>Forma dy dimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma natyrale. - Forma gjeometrike. <p>Ngjyrat ::</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrat primare: e verdhë, e kuqe (magenta), blu (cian) - Ngjyrat sekondare: jeshile, portokalli, lejla. <p>Vlera :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Drita dhe hija. <p>Tekstura</p> <ul style="list-style-type: none"> - Materiale me tekstura të ndryshme. <p>Motivi</p> <ul style="list-style-type: none"> - Motive të ndryshme në krijim. <p>Forma tre dimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format tre dimensionale. 	<ul style="list-style-type: none"> - Dallon që vijat kanë cilësi të ndryshme dhe mund të krijojnë forma, lëvizje, teksturë, motive. - Zhvillon simbole personale që prezantojnë figura e objekte të njohura për të. - Kupton që vija e horizontit krijon thellësinë në krijim. - Eksperimenton me format në krijim (në kolazh, në stampim, në vizatim, në pikturë). - Dallon siluetin dhe hijet e objektit. - Krijon me format gjeometrike dhe natyrale. - Zhvillon ndjeshmërinë ndaj ngjyrave në mjedisin që e rrethon. - Analizon ngjyrat, i përzier ato në mënyrë të qëllimshme. - Përdor ngjyrat e para dhe të dyta (primare dhe sekondare) dhe materiale me sipërfaqe të ndryshme në krijim. - Dallon ngjyrat e pastra nga tonet e ngjyrave të përziera. - Përdor tonet dhe ngjyrat për të krijuar theksin. - Dallon teksturën nëpërmjet të prekurit dhe të parit. - Krijon mbi materiale me tekstura të ndryshme, duke përdorur një sërë mjetesh dhe materialesh. - Dallon motivin në mjedisin që e rrethon (retë, gjethet, lulet, muratura, lulet zvarranike, gardhin, etj) dhe e përdor në krijim. - Dallon formën tredimensionale të objekteve në natyrë dhe ambjentin që e rrethon (volumi i gurit, i lodrave, i topit, i kutisë, i kafshëve, etj.).

<p>Organizimi i hapësirës (parimet):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Renditja, krahasimi. - Përsëritja alternimi. - Simetria dhe asimetria. - Perspektiva me objektet afër larg. 	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton marrëdhënien midis pjesëve të një objekti në krijim dhe mjedisit që e rrethon; - Krijon dhe kupton formën tre dimensionale nëpërmjet përdorimit të plastelinës. - Kupton se si njerëzit dhe objektet zënë vend në hapësirë. - Shfaq deri diku, në vizatim dhe pikturë, ndjesinë proporcioneve midis figurës njerëzore dhe objekteve. (duke i vizatuar objektet larg të vogla dhe duke i vendosur ato në nivele më të larta në krijim). - Dallon përsëritjen dhe variacionon në punën e tij dhe të shokut (linjën, ngjyrën, formën). - Përdor format simetrike dhe asimetrike në krijim.
<p>KLASA 3</p>	
<p>Vija: Përsëritja e vijës krijon lëvizje.</p> <p>Forma dydimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma natyrale, forma gjeometrike. - Imadh, ivogël. <p>Ngjyrat :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrat e ndërmjetme: e verdhë në portokalli, jeshilenë të verdhë, lejlanë blu, e kuqenë portokalli, etj. <p>Vlera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tonet e çelëta dhe të errëta. <p>Tekstura:</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbulon që lëvizja mund të krijohet nëpërmjet përsëritjes së vijës; - bëhet më i ndjeshëm ndaj formave dhe marrëdhënieve midis tyre në ambjentin që e rrethon, në veprat e artit dhe në krijimet e tij/saj; - zbulon përdorimin e ngjyrave të ndërmjetme në krijim; - zhvillon ndjeshmërinë ndaj ngjyrave dhe toneve në ambjentin rrethues; - përzien ngjyrën me të bardhën për të realizuar tonet e çelëta dhe me të zezën për të realizuar tonet e errëta; - dallon dhe krijon teksturën e prekshme me plastelinë, kolazh, etj.; - zbulon motivin në natyrë dhe në mjedisin që e rrethon (rrathëtnëujë, gjurmëtmbi rërë, lulet, gjetet, etj) dhe krijon ritmin nëpërmjet përsëritjes së motivit dhe ngjyrës; - zbulon format në arkitekturë që variojnë nga kubi, sfera, cilindri, piramida, koni;

<ul style="list-style-type: none"> - Tekstura e prekshme. <p>Motivi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Motive të ndryshme në krijim. - Përsëritja, ndërthurja. <p>Forma tredimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Trupat gjeometrikë dhe format arkitektonike. <p>Organizimi i hapësirës (parimet):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simetria rrethore. 	<ul style="list-style-type: none"> - zbulon simetrinë rrethore si një nga llojet e ballancës; - vizaton objektet larg të vogla dhe ato afër më të mëdha; - zbulon se si njerëzit dhe objektet zënë vend në hapësirë dhe e pasqyrojnë në krijim.
KLASA 4	
<p>Vija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vija (e hollë, e trashë, e drejtë, e harkuar, e thyer, zig zag etj.) krijon forma, sipërfaqe, ritëm. <p>Forma dydimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Thjeshtëzimi i formave. <p>Ngjyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ngjyrat e ngrohta: e verdhë, portokalli, e kuqe. - Ngjyrat e ftohta: blu, jeshile, lejla. <p>Vlera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tonet e çelëta dhe të errëta të 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dallon dhe përdor lloje të ndryshme vijash për të krijuar forma, sipërfaqe dhe ritëm; - zbulon dhe demonstroi që format e përbëra mund të thjeshtëzohen në format bazë gjeometrike; - zhvillon ndjeshmërinë ndaj ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta dhe i përdor në krijim; - krijon tonalitetet e çelëta dhe të errëta të ngjyrave nëpërmjet përzierjes së tyre me të bardhën dhe të zezën; - interpreton teksturën e objekteve në sipërfaqe dydimensionale (pikturë, vizatim, apo stampim); - përdor vijën, formën, ngjyrën si motiv dhe i përhap nëpërmjet përsëritjes dhe ndërthurjes në krijimet dy dhe tredimensionale;

<p>ngjyrave.</p> <p>Tekstura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstura vizuale. <p>Motivi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përsëritja ndërthurja e motivit në krijim. <p>Forma tredimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekt tredimensional me materiale të riciklueshme. <p>Organizimi i hapësirës (parimet):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Asimetria. - Perspektiva, (mbivendosja). 	<ul style="list-style-type: none"> - kupton natyrën tredimensionale të objekteve dhe interpreton formën dhe teksturën e tyre në krijim; - përdor materiale të ndryshme për të krijuar objekte tredimensionale; - krijon një objekt asimetrik tredimensional të balancuar. - krijon hapësirën dhe thellësinë në vizatim dhe pikturë, nëpërmjet mbivendosjes së objekteve dhe zvogëlimit të tyre në thellësi; - dallon se si njerëzit dhe objektet zënë vend në hapësirë dhe e pasqyrojnë në krijim;
<p>KLASA 5</p>	
<p>Vija:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vijat që bashkohen në një pikë. <p>Forma dydimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma dydimensionale e objektit në varësi të pikës së shikimit <p>Ngjyrat:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kontrasti i ngjyrave. <p>Vlera :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerat tonale të ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zbulon që vijat që bashkohen në një pikë krijojnë thellësi dhe lëvizje; - zbulon që format mund të ndryshojnë kur shihen nga pika të ndryshme shikimi; - zhvillon ndjeshmërinë ndaj kontrastit të ngjyrave dhe e përdor në krijim; - zhvillon ndjeshmërinë ndaj dallimeve të vogla midis ngjyrave dhe toneve në mjedisin rrethues; - përdor variacionet tonale të ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta në krijim; - krahason cilësinë e teksturës në punimet dy dhe tredimensionale (p.sh., piktura dhe relievi); - analizon motivin në mjedisin rrethues (sipërfaqen e shportës së endur me thupra, valët mbi det, gurët e zallit në bregdet, etj.) dhe e përsërit duke e ndërthurur atë

<p>Tekstura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tekstura vizuale dhe e prekshme. <p>Motivi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përsëritja dhe ndërthurja e motiveve në natyrë krijojnë sipërfaqe. <p>Forma tredimensionale:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekt tredimensional i përbërë nga forma të ndryshme gjeometrike. <p>Organizimi i hapësirës (parimet):</p> <ul style="list-style-type: none"> - Simetria dhe asimetria. - Perspektiva lineare. 	<ul style="list-style-type: none"> në krijim; - kupton natyrën tredimensionale të objekteve dhe zbulon marrëdhënien e pjesëve në një objekt me forma të përbëra; - përdor materiale të ndryshme për të krijuar objekte tredimensionale; - krijon portretin e njeriut me plastelinë në mënyrë simetrike dhe përdor asimetrinë në pjesën e flokëve; - vazhdon të zhvillojë vetëdijen se si njerëzit dhe objektet zënë vend në hapësirë dhe e pasqyron në krijim; - përdor perspektivën lineare për të paraqitur hapësirën në krijim (rruga e drejtë ose rruga e gjarpëruar,).
---	---

1.2 Tematika: Teknika dhe procese artistike

Përshkrimi i tematikës: Nxënësi krijon punë dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknika të ndryshme artistike dhe

një sërë stimuljsh në përshtatje me moshën. Ndjekja e procesit të realizimit është pjesë e rëndësishme e krijimtarisë. Eksperiencat, vëzhgimi dhe imagjinata e nxënësit janë pjesë e rëndësishme e procesit krijues. Nxënësi krijon nga kujtesa, vëzhgimi dhe imagjinata, në mënyrë individuale, por ndonjëherë edhe në grup. Nxënësi inkurajohet të reflektojë mbi përvojat e tij krijuese dhe për të folur mbi aspekte që janë të rëndësishme për të.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:

- **Krijimi artistik:** përdor ide personale dhe stimuj për krijim; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; identifikon këto elemente të artit pamor në mjedisin që e rrethon apo në vepra arti; përfundon krijimin e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese.
- **Realizimi i punit:** përdor ide krijuese i frymëzuar nga stimuj dhe teknika artistike; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; organizon elementet e artit në hapësira dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknikën e duhur për të përcjellë një mesazh; përfundon punën e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese.
- **Vlerësimi artistik:** zbulon vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, imazhe të medias, krijimet e veta dhe të tjerëve, për elementet e përmbajtjes; zbulon një vepër arti, objekte të trashëgimisë, në kontekstin e tyre social kulturor; komunikon emocionet e tij/saj dhe atë që zbuloi mbi veprën e artit; bën një gjykim kritik ose estetik; ndan eksperiencën e tij të vlerësimit.

Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës
--	---

KLASA 1

- | | |
|---|--|
| <p>Vizatimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps. <p>Piktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akvarele, tempera, guash, me ndihmën e | <ul style="list-style-type: none"> - Eksperimenton me mjete dhe materiale të ndryshme të vizatimit, pikturës, stampimit, skulpturës, konstruksioneve, tekstileve. - Krijon me teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në eksperiencat personale ose imagjinatën. |
|---|--|

<p>penelave të sheshtë dhe të shumëllojshëm, lapsa me ngjyra, lapustila, shkumësa, pastela, letra me ngjyra etj.</p> <p>Stampimi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Monotipi me bojra guashi, stampim me objekte të ndryshme, stampim me stampa me gricje. <p>Modelimime plastelinë</p> <p>Konstruksioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekte tre dimensionale si: kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni. <p>Tekstilet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlhura të ndryshme, fije pejrash, etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - Vizaton formën e objekteve natyrale dhe format e objekteve të krijuara (format gjeometrike) në krijim. - Vizaton siluetin e objekteve, formën e tyre nëpërmjet dritë – hijes. - Pikturon objekte që kanë ngjyra të veçanta: lule, objekte nga natyra, lodra me sfond imagjinar, etj. - Përdor për stampim objekte që kanë teksturë dhe formë interesante. me lëvozhgën e pemës, fruta, perime, etj. - Stampon me një model stampe të gdhëtur vetë (plasteline, patate). - Përdor pak ngjyra në stampim për tu fokusuar te tekstura, forma, motivi, format negative. - Modelon një sferë prej plasteline duke i dhënë formën e një figure: të një kafshe ose të një zogu e më pas duke punuar teksturën e tij nëpërmjet gricjes. - Zbulon se si mund të arrijë balancën në një konstruksion. - Përdor letra me ngjyra të forta për thurje (thurje e thjeshtë me letër). - Krijon një skulpturë të butë me çorape. - Vlerëson punën e tij/saj dhe të tjerëve, duke përshkruar mjetet e përdorura, njohuritë në përshtatje me këtë nivel. - Familjarizohet me vepra arti, artizanati dhe objekte të trashëgimisë kulturore nga vende, kohë dhe stile të ndryshme, që ilustrojnë njohuritë e programit.
---	--

KLASA 2

Vizatimi:

- Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps.

Piktura:

- Akuarele, tempera, guash, me ndihmën e penelave të sheshtë dhe të shumëllojshëm, lapsa me ngjyra, lapustil, pastel, letra me ngjyra, etj.

Stampimi:

- Monotipi me bojra guashi, me objekte të ndryshme, me stampa me gricje, stampë me relief.

Modelimime plastelinë.

Konstruksioni :

- Objekte me formë tre dimensionale si: kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni.

Tekstilet :

- Pëlhura të ndryshme, fije të ndryshme, etj.

- Eksperimenton me mjete dhe materiale të ndryshme të vizatimit, pikturës, stampimit, skulpturës, konstruksioneve, tekstileve.

- Krijon me teknika të ndryshme artistike duke u mbështetur në eksperiencat personale ose imagjinatën.

- Vizaton dhe krijon vëllimin e objekteve nëpërmjet dritëhijes, hijen e vetë objektit dhe hijen e mbartur.

- Përdor ngjyrat e para dhe të dyta dhe materiale që imitojnë sipërfaqe të ndryshme, si letra me ngjyra, katrona, copa, fije, gazeta etj.

- Dallon ngjyrat në natyrë dhe kupton ndryshimet tonale të tyre, të çelëta, të errëta dhe ngjyra të pastra.

- Përdor objekte që kanë teksturë dhe formë interesante në stampim; me lëvozhgën e pemës, me lloje të ndryshme pëlhurash, etj.

- Kupton efektin që krijon stampimi mbi materiale me sipërfaqe të ndryshme, si: copë e ashpër, karton, letër e rrudhosur, letër e stampuar etj.

- Krijon stampë plasteline me relief për të krijuar kopertinë e një libri.

- Krijon, duke transformuar trupa gjeometrikë në objekte të figurshme: vazo, enë, mobilie, karrige, tavolina, kolltukë etj.

- Manipulon formën e një sfere, për të krijuar figurën e njeriut.

	<ul style="list-style-type: none"> - Kombinon lloje të ndryshme hapësirash dhe sipërfaqesh në një <i>punë tredimensionale</i>, duke përdorur plastelinën apo lodra konstruksioni, si dhe materiale të tjera si: kartonë, letra të printuara me sipërfaqe të ndryshme, për të krijuar, p.sh.: sipërfaqen e çatave, e murit, e rrugës etj. - Vëzhgon karakteristika të vendbanimit të insekteve apo shpendëve, i interpreton në punën e tij, duke përdorur dru, degëza, lëvore misri, gjethe dhe materiale të tjera natyrale. - Kombinon fije me ngjyra të ndryshme në formë shiritash, për të realizuar njëthurje të thjeshtë. - Krijon qendrën e interesit, duke ndërthurur fijet dhe rruazat në bizhuteri të thjeshta. - Zhvillon formën tredimensionale, ngjyrën dhe sipërfaqen në një skulpturë të butë. - Vlerëson punën e tij/saj dhe të tjerëve, duke përshkruar mjetet e përdorura, njohuritë në përshtatje me këtë nivel. - Familjarizohet me vepra arti, artizanati dhe objekte të trashëgimisë kulturore nga vende, kohë dhe stile të ndryshme, që ilustrojnë njohuritë e programit.
- KLASA 3	
<p>Vizatimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps. <p>Piktura:</p>	<ul style="list-style-type: none"> - eksperimenton me vijat, format, teksturën, tonet, duke përdorur mjete të ndryshme vizatimi mbi sipërfaqe të ndryshme në krijim (Minialbum mbi motin); - krijon vëllimin në përmjet dritës dhe hijes në objektet nga

<ul style="list-style-type: none"> - Aquarele,tempera,guash,penelatësheshtëdhe tëshumëllojshëm, letrame ngjyra, pasteleetj. <p>Stampimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bojra uji(guashi,tempera,akrilike),objekte të ndryshme, stampa me gricje,stampa prej letre, etj. <p>Modelimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plastelinë, argjil, brum, letra higjenike (për teknikën ecarta pesta). <p>Konstruksioni:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekte me formë tredimensionale si:kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni dhe materialetë tjera ndihmëse. <p>Tekstilet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlhura të ndryshme, fije të ndryshme, dhe materialetë tjerandihmëse,etj. 	<p>natyra;</p> <ul style="list-style-type: none"> - krijon, duke përdorur e fektet hapësinore të ngjyrave dhe toneve; - përdor ngjyrat dhe tonet për të krijuar planet afër dhe larg, në një pikturë nga natyra; - krijon forma të ndryshme negative për stampime stensil(shablloneletre), duke i ngjyrosur me spërkatësose penel; - stampon objekte të përdorimit të përditshëm si:shaminë, kutinë e lodrave etj, duke përdorur ngjyra të ndërmjetme dhe një motiv të parapëlqyer; - krijon një poster duke përdorur gërma dhe figura të prera nga revistat; - përdor forma, dekorime dhe efektet e teksturës me plastelinë për të krijuar bizhuteri; - manipulon tiparet në një maskë me teknikën e cartapesta(i zmadhon, shtrembëron,zvogëlon), për të krijuar formën e dëshiruar; - manipulon një trup të gatshëm gjeometrik, duke i dhënë formën e një objekti funksional dhe përdor ngjyra dhe dekorime mbi të; - krijon një skulpturë simetrike,duke përdorur materiale natyrale,si:druri, guralecë, fara,pupla, etj.; - krijon qendrën e interesit nëpërmjet formës, ngjyrës, sipërfaqes në byzylyk ose gjerdan me fije të thurura dhe dekorime;
--	--

	<ul style="list-style-type: none"> - krijon një gobelinë me motive popullore nëpërmjet teknikës së kolazhit me pëlhurë; - analizon dhe krahason vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme; - vlerëson punën e tij/saj dhe të tjerëve, duke përshkruar mjetet e teknikat e përdorura, njohuritë në përshtatje me këtë nivel.
<p>- KLASA 4</p>	
<p>Vizatimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps. <p>Piktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akuarele, tempera, guash, penela të sheshtë dhe të shumëllojshëm, letra me ngjyra, etj. <p>Stampimi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bojëra uji (guashi, tempera, akrilikë), objekte të ndryshme, stampa të ndryshme (me gricje, me relief, me letër). <p>Modelimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plastelinë, argjil, brum, letra higjenike (për teknikën e carta pesta). <p>Konstruksioni :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekte me formë tredimensionale si: kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni, materiale të tjera ndihmëse. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vizaton objekte nga natyra duke i parë nga pika shikimi të ndryshme; - krijon motive dhe detaje në tema që mbështeten në imagjinatën si: <i>Liza në Botën e çudirave</i> ose <i>Ëndrra</i>; - krijon një mozaik me letër duke kombinuar ngjyrat e ngrohta e të ftohta; - përdor ngjyrat dhe tonet për të krijuar planet në një peizazh; - pikturon një objekt tredimensional duke theksuar pjesën më të rëndësishme, nëpërmjet përdorimit të kontrastit të ngjyrave; - krijon <i>format pozitive dhe negative</i> në stampat me relief, si: plastelinë, patate, sapun për të stampuar mbi letër, pëlhurë ose karton; - përdor vizatimet e veta për stampa stensil (me letër) dhe sprajin ose sfungjerin, për të stampuar mbi materiale të ndryshme; - krijon, duke e përzier teknikën e stampimit me teknika të tjera,

<p>Tekstilet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlhura të ndryshme, fije të ndryshme, etj. 	<p>p.sh., pastel, lapsa me ngjyra, etj.;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdor forma të ndryshme gjeometrike dhe natyrale për të krijuar enë të thjeshta kuzhine dhe zbukuron sipërfaqen e tyre me relief (plastelinë); - krijon skulpturë abstrakte me letër, duke ngjitur, ngjyrosur dhe balancuar të gjitha pjesët në një të tërë; - eksperimenton me kuba dhe drejtkëndësja, për të krijuar ndërtesa të ndryshme; - krijon një strukturë imagjinare në formën e moketit duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash; - eksperimenton me fije, copa, kopsa mbi pëlhurë, për të krijuar një dizajn të ri; - krijon skulpturë me materiale të buta; - mbështetet për punën e tij në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme; - vlerëson punën e tij dhe të tjerëve, duke përshkruar mjetet e teknikat e përdorura, njohuritë në përshtatje me këtë nivel.
<p>- KLASA 5</p>	
<p>Vizatimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mjete të ndryshme si: laps, lapustil, shkumës, pastel, stilolaps, rapitograf. <p>Piktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Akvarele, tempera, guash, penela të sheshtë 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vëzhgon me vëmendje objektet e ndryshme dhe interpreton cilësitë e linjës, formës, sipërfaqes, dritës dhe hijes; - vizaton dhe pikturon nga natyra tema të tilla si: “Natyre e qetë”; “Vizatim nga dritarja e klasës”; skica “Shoku ose

<p>dhe të shumëllojshëm, letra me ngjyra për kolazh e mozaik.</p> <p>Stampimi :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Bojëra uji (guashi, tempera, akrilikë), objekte të ndryshme, stampa të ndryshme (me gricje, me relief, me letër). <p>Modelimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Plastelinë, argjilë, brumë letra higjienike (për teknikën e carta pesta). <p>Konstruksioni :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekte me formë tredimensionale si: kuba prej kartoni, letër dhe lojëra konstruksioni. <p>Tekstilet :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pëlhura të ndryshme, fije të ndryshme, ngjyra për ngjyrosje, etj. 	<p>shoqja e klasës në pozicione të ndryshme”;</p> <ul style="list-style-type: none"> - luan me proporcionet e tipareve të portretit për të krijuar karikaturën e një personazhi; - krijon mozaik me letër ose me revista duke përdorur kontrastin e ngjyrave; - përzgjedh mjete dhe materiale të pikturës për të paraqitur personazhin e preferuar në krijim; - krijon stampim me relief, duke krijuar linjën me vinovil; - stampon objekte funksionale me motive dhe logo, një shami, një çantë, një kuti etj.; - krijon me plastelinë trupin e njeriut, duke u kujdesur për të realizuar proporcionet dhe një gjendje emocionale të caktuar; - përdor forma të ndryshme natyrale ose gjeometrike, për të krijuar vazo ose enë në plastelinë; - manipulon formën për të arritur rezultatin e dëshiruar në një maskë komike me teknikën e karta pesta; - krijon një ndërtesë imagjinare ose një objekt, duke përdorur shumëllojshmëri hapësirash për një strukturë komplekse; - krijon një personazh të marrë nga një tekst letrar dhe kostumin e tij, duke përdorur copa dhe fije; - eksperimenton një ngjyrosjeje të thjeshtë pëlhure; - mbështetet për punën e tij në vepra arti, artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore, dizajni dhe arkitekture nga vende, kohë dhe stile të ndryshme;
--	--

	- vlerëson punën e tij dhe të tjerëve, duke përshkruar mjetet e teknikat e përdorura, njohuritë në përshtatje me këtë nivel.
--	--

1.3 .Tematika: Historia, arti dhe shoqëria

<p>Përshkrimi i Tematikës: Nxënësi merr pjesë në aktivitete të shkurtra, në të cilat ai vëzhgon vepra arti nga e shkuara, e tashmja dhe nga kultura të ndryshme, duke përfshirë edhe krijimet e tij dhe të shokëve/shoqeve të klasës. Përmbajtja e veprave të artit, të paraqitura nëpërmjet posterave apo në rrugë elektronike audio vizuale, duhet të jetë e përshtatshme për eksperiencën kulturore të kësaj grupmoshe. Ato janë shumë të rëndësishme si kritere të paracaktuara të vëzhgimit në lidhje me zhvillimin e stimulimit të krijimit, me teknikat artistike, studimit të elementeve të artit, po aq sa te emocioneve dhe përshtypjeve. Nxënësi komunikon vlerësimin me gojë ose me shkrim.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit për kompetencat e lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Krijimi artistik: përdor ide personale dhe stimuj për krijim; përdor elementet e artit pamor dhe teknikat artistike; identifikon këto elemente të artit pamor në mjedisin që e rrethon apo në vepra arti; përfundon krijimin e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese. • Realizimi i punimit: përdor ide krijuese i frymëzuar nga stimuj dhe teknika artistike; përdor teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellë; organizon elementet e artit në hapësira dy dhe tre dimensionale duke përdorur teknikën e duhur për të përcjellë një mesazh; përfundon punën e tij/saj; ndan eksperiencat e tij/saj krijuese. • Vlerësimi artistik: zbulon vepra arti, objekte të trashëgimisë kulturore, imazhe të medias, krijimet e veta dhe të tjerëve për elementet e përmbajtjes; zbulon një vepër arti, objekte të trashëgimisë, në kontekstin e tyre social kulturor; komunikon emocionet e tij/saj dhe atë që zbuloi mbi veprën e artit; bën një gjykim kritik ose estetik; ndan eksperiencën e tij të vlerësimit. 	
Njohuritë për realizimin e kompetencave të lëndës	Shkathtësitë për realizimin e kompetencave të lëndës

KLASA 1	
<p>Histori Arti :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore). - Objekte tradicionale kulturore. <p>Eksperienca artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës. - Takime me artistë, dizajnë e artizanë. <p>Ekspozita dhe evente kulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në muzeume, galeri arti, qendra kulturore, etj. - Ekspozita me punimet e fëmijëve për projekte të ndryshme dhe në fund të vitit. <p>Punimet e fëmijëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tema specifike mësimore. <p>Media:</p> <p>Libra, revista, postera, filma, etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon me kuriozitet veprat e artit dhe objekte të ndryshme artizanati. - Përshkruan atë që sheh në një vepër arti, artizanati ose objekt të trashëgimisë kulturore. - Identifikon dhe përshkruan ngjyrat dhe format, dritën dhe hijen; - Përshkruan pjesën që i pëlqen më shumë. - Zbulon profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si: artistë, artizanë. - Viziton një muze, galeri apo qendrën kulturore . - Merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë. - Vëzhgon, përshkruan dhe krahason punimet e nxënësve që lidhen me tema specifike mësimore. - Përdor burime të ndryshme informacioni.
KLASA 2	
<p>Histori Arti :</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon me kuriozitet veprat e artit, objekte të ndryshme artizanati

<ul style="list-style-type: none"> - Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore). - Objekte tradicionale kulturore. <p>Eksperienca artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në studiot e artistëve, punishtet e artizanëve të zonës. - Takime me artistë, dizajnë e artizanë. <p>Ekspozita dhe evente kulturore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vizita në muzeume, galeri arti, qendra kulturore, etj. - Ekspozita me punimet e fëmijëve për projekte të ndryshme dhe në fund të vitit. <p>Punimet e fëmijëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lidhur me tema specifike mësimore. <p>Media:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Libra, revista, postera, filma, etj. 	<p>dhe trashëgimisë kulturore;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vëzhgon dhe përshkruan vijat, format, ngjyrat, teksturat, dritën dhe hijet në një vepër arti; - Përshkruan çfarë i pëlqen më shumë në një vepër arti ose objekt; - Përshkruan punën e tij/saj, punën e shokut dhe atë që sheh në një krijim. - Zbulon profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si: artistë, artizanë, mësues arti, dizajn. - Viziton një muze, galeri apo qendrën kulturore, sit arkeologjik; - Merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë. - Vëzhgon, përshkruan dhe krahason punimet e nxënësve që lidhen me tema specifike mësimore. - Përdor burime të ndryshme informacioni.
KLASA 3	
<p>Vepra të ndryshme arti¹</p> <p>Artistë dhe vepra²</p> <ul style="list-style-type: none"> - VinsentVanGog:“Nata me yje” 	<ul style="list-style-type: none"> - vëzhgon me kuriozitet veprat e artit, të arkitekturës, objekte të ndryshme artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore dhe objekte dizajni të përdorimit të përditshëm në përshtatje me

<ul style="list-style-type: none"> - Henri Matis (Henri Matisse): “Kafshët e detit”ose“Polinezia, Deti” - Parthenoni,Athinë,Greqi. - Kolë Idromeno “Dasma Shkodrane” <p>Eksperienca artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me artistë ose artizanë. - Ekspozita e fundvitit <p>Media:</p> <p>Libra, revista, postera, filma,etj.</p>	<p>njohuritë e konceptetqë përmban programi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan çfarë ndodh në vepër; - vëzhgon dhe përshkruan: vijat, format, teksturat, dritën dhe hijet, ngjyrat, teksturën në një vepër arti ose objekt dizajni; - përshkruan çfarë i pëlqen më shumë në një vepër ose objekt arti; - përdor vepra të tilla arti si nxitje për punën e tij; - përshkruan punën e tij/saj, punën e shokut dhe atë që sheh në një krijim; - zbulon profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si:artistja po artizani; - merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë; - përdor burime të ndryshme informacioni si nxitje në punën e tij/saj.
KLASA 4	
<p>Vepra të ndryshme arti²</p> <p>Artistë dhe vepra³</p> <ul style="list-style-type: none"> - Henri Ruso (Henry Rousseau), “Xhungla”. - Joan Miro, “Skulptura”. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vëzhgon me kuriozitet veprat e artit, të arkitekturës, objekte të ndryshme artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore dhe objekte dizajni të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë e konceptet që përmban programi;

²Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore). Ato mund të përdoren për të ilustruar njohuritë e marra nga tematikat “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika dhe procese artistike”.

³Vepra arti dhe artistë sugjerohen si tema mësimore në këtë tematikë.

<ul style="list-style-type: none"> - Abdurrahim Buza “Lojëra popullore”. - Objekte funksionale artizanati dhe dizajni. <p>Eksperiencia artistike:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me arkitekt ose dizajn. - Ekspozita e fundvitit. <p>Media:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Libra, revista, postera, filma etj. 	<ul style="list-style-type: none"> - përshkruan çfarë ndodh në vepër; - vëzhgon dhe përshkruan: <i>vijat, format, teksturat, dritën dhe hijet, ngjyrat, tonet, motivin dhe ritmin, hapësirën në një vepër arti;</i> - përshkruan materialet e përdorura në një objekt të stampuar, vazo, tekstil, etj; - përdor vepra të tilla arti si nxitje për punën e tij; - përshkruan punën e tij, punën e shokut dhe atë që sheh në një krijim; - zbulon profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si: arkitekti apo dizajni; - merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë; - Përdor burime të ndryshme informacioni.
KLASA 5	
<p>Vepra të ndryshme arti⁴</p> <p>Artistë dhe vepra⁵</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mark Shagall (Marc Chagall) “Unë dhe fshati”. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vëzhgon me kuriozitet veprat e artit, të arkitekturës, objekte të ndryshme artizanati, objekte të trashëgimisë kulturore dhe objekte dizajni të përdorimit të përditshëm në përshtatje me njohuritë e

⁴Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme (prehistoria, antikiteti, mesjeta, rilindja, baroku, klasike, romantike, lëvizjet moderne dhe post moderne, bashkëkohore). Ato mund të përdoren për të ilustruar njohuritë e marra nga tematikat “Gjuha dhe komunikimi artistik” dhe “Teknika dhe procese artistike”.

⁵Vepra arti dhe artistë sugjerohen si tema mësimore në këtë tematikë.

<ul style="list-style-type: none"> - Portret nga dy periudhave të ndryshme artistike (p. sh., “portret abstrakt” nga Pol Kle dhe “Vajza me perlë” nga Johan Vermer) - Vangjush Mio “Pejzazhe”. - Tekstilet tradicionale dhe bashkëkohore. <p>Eksperiencia artistike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Takim me mësues arti ose kostumograf. - Ekspozita e fundvitit. <p>Media</p> <ul style="list-style-type: none"> - Libra, revista, postera, filma, etj. 	<p>konceptet që përmban programi;</p> <ul style="list-style-type: none"> - përshkruan çfarë ndodh në vepër; - vëzhgon dhe përshkruan: <i>vijat, format, teksturat, dritën dhe hijet, ngjyrat, tonet, motivin dhe ritmin, hapësirën në një vepër arti;</i> - krahason vepra të ndryshme ose objekte të ndryshme artistike në lidhje me të njëjtin subjekt; - krijon duke u mbështetur në vepra të caktuara arti; - përshkruan punën e tij, punën e shokut dhe atë që sheh në një krijim; - zbulon profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si: mësues arti apo kostumografë; - merr pjesë në ekspozimin e punimeve në klasë. - merr pjesë nëveprimtari të ndryshme dhe projekte, duke dhënë ndihmesën e tij nga ana krijuese dhe estetike, në klasë dhe shkollë (p. sh., Viti i ri, festivali i luleve, aktivitetet për festat kombëtare në shkollë ose klasë, etj); - përdor burime të ndryshme informacioni.
<p>Qëndrime dhe vlera:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Paraqet kuriozitet për një sërë objektesh dhe imazhesh të njohura dhe të panjohura në ambjentin që e rrethon duke u fokusuar në cilësitë e tyre vizuale. - Zbulon dhe zhvillon ndjeshmërinë ndaj cilësisë së linjës, formës dy dhe tre dimensionale, ngjyrës, teksturës, motivit dhe ritmit në natyrë, në veprat e artit dhe në krijimet e tij/saj. - Shpreh ide, ndjenja dhe eksperiencia nëpërmjet artit pamor. - Përdor imagjinatën dhe kreativitetin për të krijuar. 	

- Eksperimenton në mënyrë spontane për të krijuar me një sërë mjetesh artistike si lapsin, bojrat e ujit, lapsat me ngjyra, lapustilat, shkumsat, plastelinën, tekstilet dhe fijet, materialet e konstruksionit.
- Diskuton për elementet e preferuar në punën e tij/saj dhe të shokut.
- Paraqet kuriozitet për vepra të ndryshme artistike dhe të artizanatit.
- Demonstron vetëbesim në aktivitete të ndryshme artistike.
- Ka dëshirë të shprehet dhe të komunikojë në mënyrë të pavarur.
- Merr pjesë aktive në veprimtaritë e artit pamor vetëm dhe në grup.
- Demonstron dëshirë për përmbushjen e detyrës.
- Bashkëpunon me të tjerë në një veprimtari artistike.
- Respekton diversitetin ndaj kulturave të ndryshme.
- Demonstron respekt për veten dhe të tjerët.
- Mban qëndrim ndaj veprave të ndryshme artistike dhe të artizanatit.
- Vlerëson trashëgiminë kulturore të cilës i përket
- Demonstron përqëndrim dhe durim gjatë punëve krijuese

9.Udhëzime metodologjike

Përdorimi i metodologjive në procesin e të nxënit në artin pamor është kusht për rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin pamor/artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimt të artit pamor do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë mjedisin vizual dhe krijojnë nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike. Kjo arrihet vetëm nëpërmjet një motivimi të drejtë dhe përkundrejt zhvillimit të një kompetence të caktuar nëpërmjet rezultateve të të nxënit dhe tematikave përkatëse mësimore.

Mësimdhënia e artit pamor, për nga vetë natyra, nënkupton një veprimtari emocionale dhe fizike. Çdo përmbajtje dhe veprimtari mësimore në artin pamor, është e pëlqyeshme dhe krijon emocione, kur nxënësit drejtohen drejt një veprimtarie në mënyrë të vetëdijshme, ç'ka u mundëson atyre shprehjen e potencialit të tyre intelektual/artistik në shumë aspekte.

Mësimdhënia në artin pamorsynon gjithë përfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet dhe bazohet ***në mësimdhënien dhe nxënien bazuar në kompetenca. mësimdhënien me në qendër nxënësin dhe mësimdhënien e nxënien e integruar.***

Nxënësit e një klase janë të ndryshëm, përsa i përket mënyrës se si ata nxënë: individualisht, në grup, nën udhëheqjen e mësuesit, të pavarur, me anë të mjeteve konkrete, etj.

Planifikimi dhe përzgjedhja e metodave të mësimdhënies në mësimin e artit pamor mban parasysh:

- Kompetencat kryesore të të nxënit në artin pamor.
- Lidhjen konceptuale, ruajtjen e koherencës vertikale të njohurive e aftësive në kuptimin që ndërtimi i çdo njohurie dhe edukimi i çdo aftësie mbështeten në ato të mëparshmet.
- Formimin dhe forcimin e aftësive bazë të artit pamor.
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin pamor, brenda dhe jashtë klasës, të cilat lidhin konceptet pamore me situata të jetës reale.
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë.
- Veçoritë e veprimtarive në mënyrë individuale dhe në grup.
- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit pamor dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij.
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit.

Një mësimdhënie e mirëmenuar dhe e mirëplanifikuar, krijon kushtet e nevojshme për një nxënie të suksesshme dhe lehtëson, si punën e mësuesit, ashtu edhe atë të nxënësit. Kompetencat e artit pamor, që janë të përcaktuara në këtë program, janë të ndërlidhura

dhe zhvillohen nëpërmjet situatave të të nxënësve që kanë në qendër pjesëmarrjen aktive të nxënësve. Ata janë aktiv kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin pamor.

Gjithashtu, është e rëndësishme që nxënësi të punojë me situata ku i kërkohen arsye apo përgjigje të pyetjeve të tilla si “...pse më pëlqen?”, “...a duket bukur?”, “...çfarë ndodh nëse e vendos objektin më afër?” etj. Në këtë mënyrë ai inkurajohet të reflektojë mbi veprimet e tij dhe të ndërmarrë situata të reja.

Cilësia e mësimdhënies është çelësi për suksesin e fëmijëve në mësimin e artit. Mësuesit duhet të inkurajojnë çdo nxënës të besojë se do të jetë i suksesshëm në mësimin e artit, të kuptojnë interesat e nxënësve, nevojat që ata kanë, të ndihmojnë nxënësit të aktivizojnë njohuritë e mëparshme, të rendisin udhëzimet që do të përdorin, duke diferencuar udhëzimet për nxënës me nevoja të veçanta. Po kështu mësuesit duhet të stimulojnë dhe inkurajojnë të gjithë nxënësit, duke krijuar mjedise ku nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar mbi artin pamor në mënyra që janë të rëndësishme për ta.

Mësuesit mund ta realizojnë këtë nëpërmjet veprimtarive të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen me eksperiencën krijuese dhe me materiale konkrete. Planifikimi i kohës, hapësira e përshtatshme dhe një shumëllojshmëri materialesh janë të rëndësishme për të mbështetur një mësimdhënie efektive. Gjatë procesit të mësimdhënies, mësuesit duhet të sigurojnë një shumëllojshmëri aktivitete të bazuara në vlerësimin e nevojave individuale të nxënësve, në nevojat e grupit dhe në praktikën më të mira mësimore. Gjithashtu, mësuesit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë për zhvillimin e veprimtarive të “Artit pamor” që nxit idetë e reja tek nxënësit.

Projektet kurrikulare afatgjata lejojnë nxënësin të aplikojë njohuritë dhe aftësitë që zotëron nga njëra anë dhe nga ana tjetër arrin të krijojë lidhje integruese me lëndë të tjera në fushën e arteve dhe jashtë saj. Edhe prezantimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave pamore/artistike, por mbi të gjitha të kompetencave kyçe.

10.Udhëzime për vlerësimin

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënit të bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies, i cili përqëndrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Informacioni i siguruar nga vlerësimi i ndihmon mësuesit të kuptojnë anët e dobëta dhe anët e forta të nxënësve në përmbushjen e kompetencave, u jep mundësi të përmirësojnë mësimdhënien dhe të pajisin nxënësin me informacionin përkatës për progresin e tij. Sigurisht është i domosdoshëm edhe vlerësimi i përmbajtjes lidhur me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive pamore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e tyre (*psh. Vetvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezantimi me gojë, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.*)

Vlerësimi përshkon gjithë procesin mësimor dhe i shërben përmirësimit të këtij procesi. Në artin pamor vlerësimi mbështetet në parimin e individualizimit, ku çdo nxënës posedon dhe zhvillon prirje të veçanta, duke u shprehur në mënyrë individuale dhe në bashkëpunimin e realizimit të temave mësimore në grup. *Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale dhe krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezantimi* i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte. Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grup, në aktivitetet artistike të ndryshme që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e të nxënit dhe objekt i vlerësimit janë krijimi i kompetencave të artit pamor të nxënësve, përmes krijimit, interpretimit dhe vlerësimit. Arritjet në lëndën e artit pamor janë më shumë individuale, prandaj duhet edhe të vlerësohen si të tilla.

Kjo gjë bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes *krijimit, vëzhgimit, dhe analizës* së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e produkteve të ndryshme.

Portofoli i nxënësit, është një tjetër mundësi vlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor në artin pamor. Ai mund të përmbajë krijime, organizime dhe projekte kurrikulare, në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj.

Vlerësimi i nxënësve në shkallën e parë dhe të dytë bëhet sipas kompetencave përkatëse që ata duhet të zhvillojnë.

Materiale dhe burime mësimore

Gjatë zhvillimit të mëimit në lëndën e artit pamor, për realizimin e kompetencave, mësuesi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi i prek, i shikon, i përdor, etj. Ai/ajo përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon ambiente për aktivitete alternative etj. Edhe teknologjia ka një ndikim të madh në artin pamor duke ndihmuar nxënësit të eksplorojnë vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj, duke zhvilluar aftësitë e tyre në studimin e kësaj lënde.

Mësuesi përdor fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore dhe me një fjalor të pastër të gjuhës artistike pamore. Mësuesi siguron qasje përmes përdorimit të teksteve dhe materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Ai/Ajo u prezanton/sqaron nxënësve përmbajtjet caktuara ose shkathtësitë që ata duhet të performojnë.

Mësuesi u krijon mundësi nxënësve të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të mediave detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësuesi duhet të demonstrojë drejtpërdrejt gjatë mësimdhënies në lëndën e artit pamor. Është shumë e rëndësishme për nxënësit e kësaj moshe balanca, lidhja midis demonstrimit të mësuesit dhe dhënia mundësi e përdorimit të njohurive dhe aftësive të tyre në veprimtarinë artistike. Në këtë mënyrë ata do të krijojnë pavarësi në përdorimin e mjeteve nga një nivel në tjetrin. Kur mësuesit i

duhet të përdorë kontekstin kulturor të artit, duhet të marrë në konsideratë të gjitha format e artit nga e gjithë bota dhe nga kultura të ndryshme.

Programi i artit pamor u jep të gjithë nxënësve mundësinë të zbulojnë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në përdorimin e një sërë mjeteve dhe teknikave artistike dhe të vlerësojnë veprat e artit. Klasa duhet të jetë gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit në orën e artit.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

- *Fotografi të ndryshme që mbajnë informacionin e duhur për eksplorimin e elementeve të artit në natyrë dhe mjedisin rrethues.*
- *Fotografi të objekteve të ndryshme të artizanatit, të trashëgimisë kulturore, etj.*
- *Riprodhime të veprave të artit dhe postera.*
- *Mjetet audiovizive si: TV, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.*
- *Mjetet verbale, tekstet si: tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme arti, artizanati, dizajni etj.. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për artin pamor. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese.*
- *Mjedisi mësimor si: (klasa, kabinetet e artit pamor, etj.).*